

Data \_\_.\_\_.2024

## **PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

#### **OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**“Shpenzime mirëmbajtje rrugë, vepra ujore, rrjet hidraulik, elektrik, telefonik, ngrohje etj (e ndare me lote)”**

**Loti 1 “Mirembajtje e ashensoreve”**

**Loti 2 “Mirembajtje e sistemit elektrik, ventilimit elektronik dhe kunder zjarrit”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbimet të Riparimit dhe mirëmbajtjes, 50**

**VLERA E FONDIT LIMIT:** në total është: **11,948,593** (njëmbëdhjetë milion e nëntëqind e dyzet e tetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë Pa Tvsh.

Fond limit për **Lotin 1 “Mirembajtje e ashensoreve”** është: **2,080,643** (dy milion e tetëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e tre) lekë Pa Tvsh

Fond limit për **Lotin 2 “Mirembajtje e sistemit elektrik, ventilimit elektronik dhe kunder zjarrit”** është: **9,867,950** (nëntë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë pa Tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Tirana Parking ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës Nr3

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës Nr.9

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së perlllogaritur të lotit përkatës

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë sepse ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare (2021, 2022, 2023), të konfirmuara nga Administrata Tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 ”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

**2.2.3** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2024 sipas afateve të maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar prej njësisë të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ka selinë. Ky kriter plotësohet me paraqitjen e vetedeklarimit në fazën e ofertimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e TaksaveVendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar.

Ky kriter do të përmbushet nga Operatori Ekonomik me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

### LOTI 1 “MIREMBAJTJE E ASHENSOREVE”

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlogaritur të lotit.
  - Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
  - Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

**Përsa më sipër, nëse ofertuesi aplikon për të gjitha lotet, rrjedhimisht duhet të kujdeset që vlera për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, të arrijë të plotësojë vlerën e kërkuar për aq lote sa aplikon, në mënyrë që të arrijë të provojë kapacitetin e tij teknik për mundësinë e realizimit me sukses të të gjitha loteve ku aplikon.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar të V.K.M-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Liçensë të vlefshme nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për Kategorinë NS – 3 “Impiante Ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)”.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.” si dhe pika 1, neni 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar ku citohet: *“Autoriteti enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

Për vete natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët të kryejnë shërbimet dhe realizojnë objektin e kontratës me standardet e kërkuara të cilësisë.

3. Operatori ekonomik duhet të disponojë stafin e nevojshëm që duhet të jetë i përbërë nga:
  - a. Minimalisht 2 punonjës të rregjistruar gjatë 3 muajve të fundit. OE të paraqesë listepagesat për punonjësit në fjalë që të vërtetojë punësimin e këtyre të fundit,
  - b. Minimalisht 2 punonjës të cilët duhet të jenë të certifikuar për sistemet e ashensorëve. Për të përmbushur këtë kriter duhet të paraqitet dokumentacioni :
    - i. Curriculum Vitae – CV;
    - ii. Çertifikimi i tyre dhe/ose dëshmia e kualifikimit teknik sipas standartit S SH EN ISO/IEC 17024:2012, sipas Rregullores së Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Implantet, Pajisjet dhe Instalimet Elektrike, Ligji Nr. 8734, datë 01.02.2001, “Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 13/2013, datë 14.02.2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 8734 , datë 01.20.2001;
    - iii. Kontrata e vlefshme e punës;
    - iv. Nga këta dy punonjës minimalisht njëri të jetë i certifikuar nga një organ certifikues i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit - DPA, për skemën e certifikimit “S/803 – Skema dhe procesi i certifikimit të personave që kryejnë mirëmbajtjen e ashensorëve”.

**Shënim:** Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit .Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit,të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

**Argumentimi:** Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqes një deklaratë për periudhën e garancisë e cila do të jetë 1 vitë nga data e nënshkrimit të kontratës

**Argumentimi:** Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndyshuar ,si dhe kriter i vendosur në reference të specifikimeve teknike.

## **LOTI 2: “MIREMBAJTJE E SISTEMIT ELEKTRIK, VENTILIMIT ELEKTRONIK DHE KUNDER ZJARRIT”**

1. Operatori ekonomik duhet të disponojë Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit për të gjithë artikujt.

**Argumentimi:** Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndyshuar ,si dhe kriter i vendosur në reference të specifikimeve teknike.

Kriteri i përcaktuar mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesi ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Autoriteti Kontraktor duke qenë se është përfitues direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur AK garantohet dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses.

---

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlogaritur të lotit perkatës.
  - Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
  - Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

**Përsa më sipër, nëse ofertuesi aplikon për të gjitha lotet, rrjedhimisht duhet të kujdeset që vlera për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, të arrijë të plotësojë vlerën e kërkuar për aq lote sa aplikon, në mënyrë që të arrijë të provojë kapacitetin e tij teknik për mundësinë e realizimit me sukses të të gjitha loteve ku aplikon.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar të V.K.M-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

3. Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ushtron aktivitetin tregtar në fushën objekt prokurimi duke zbatuar normat e sistemit të menaxhimit të cilësisë. Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë:
  - Certifikatë cilësie sipas standartit ISO 9001:2015, ose ekuivalente me to,
  - Certifikatë cilësie sipas standartit ISO 14001:2015, ose ekuivalente me to,
  - Certificate cilësie sipas standartit ISO 45001:2018, ose ekuivalente me to,
  - Certificate cilësie sipas standartit ISO 50001:2018, ose ekuivalente me to,

- Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojnë këto certifikata në përputhje me zërat që ka marrë përsipër të kryejë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ”Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.” dhe pika 1 , neni 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Autoriteti, enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

4. Produktet duhet të jenë të pajisura me çertifikate konformiteti (CE), sipas standarteve të miratuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ”Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.” dhe pika 1 , neni 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Autoriteti, enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

5. Operatori ekonomik duhet të disponojë stafin e nevojshëm që duhet të jetë i përbërë nga:

- a. Minimalisht 10 punonjës të regjistruar gjatë 3 muajve të fundit. OE të paraqesë listepagesat,
- b. Minimalisht 1 person të jetë i çertifikuar për sistemet kundër zjarrit,
- c. Minimalisht 1 person i Çertifikuar për sisteme Audio,
- d. Minimalisht 1 person i Çertifikuar dhe për sistemet e ndriçimit të daljeve të emergjencës,
- e. Minimalisht 1 person i Çertifikuar për instalim/konfigurim të UPS,
- f. Minimalisht- 3 persona të çertifikuar për instalimin e sistemeve të ndriçimit,
- g. Minimalisht 3 inxhinjera elektronik/elektrik.

**Shënim:** Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne klasifikim duhet te dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit,tëgjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën objekt prokurimi.

6. Të disponojë në pronësi ose me qira:

- a) 2 copë mjete ngritëse me rrota për përdorim në ambiente të mbyllura (Platformë), të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë ose kontrata noteriale e qirasë si edhe fotografi të mjeteve.

**Shënim:** Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne klasifikim duhet te dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit,tëgjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

**Argumentimi:** Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjete dhe pajise teknike të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën objekt prokurimi.

7.Operatori ekonomik duhet te paraqes një deklaratë per periudhen e garancise e cila do te jete 1 vite nga data e nenshkrimit te kontrates

**Argumentimi:** Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar ,si dhe kriter i vendosur ne reference te specifikimeve teknike.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm, i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve të teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar)

Autoriteti Kontraktor Tirana Parking ka ndër të tjera, një nga objektet kryesore dhe të rëndësishme të veprimtarisë së saj, mirëmbajtjen e sistemeve të parkimit Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve



më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo edhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tijësaj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

## **LOTI 1 “MIREMBAJTJE E ASHENSOREVE”**

### **1. Për mirëmbajtjen mujore të ashensorëve të “Tirana Parking” nevojitet të zbatohen pikat e mëposhtme të detajuara:**

#### **➤ Lëvizja e kabinës:**

Nisja (përshpejtimi), lëvizja me shpejtësinë nominale, ngadalësimi.

#### **➤ Niveli (ndalja) në kate:**

Kontrolli i saktësisë së ndaljes në kate.

#### **➤ Pajisja për alarmim të emergjencës:**

Kontrolli i funksionimit të saj

#### **➤ Thirrësit (butonat) e kateve dhe indikatorët:**

Kontrolli i funksionimit normal të tyre.

#### **➤ Kabina e Ashensorit:**

Kontrolli i fiksimit të paneleve dhe të tavanit, Kontrolli i dritave.

Kontrolli i dritave emergjente, Butonave në kabinë.

Kontrolli i fiksimit të rrëshqitëseve dhe lysterëve, Ndërprerësi emergjent mbi kabinë.

Funksionimi i sensorëve.

#### **➤ Dyert e jashtme të kateve:**

Kontrolli dhe lubrifikimi.

Kontrolli i kavos (litarit metalik në mekanizëm), rripit të motorit, integriteti dhe kompaktesia e tyre.

Kontrolli i hapësirës së derës.

Kontrolli i paneleve dhe shtyrësit të tyre për mekanizëm. Kontrolli i funksionimit të dyerve të jashtme të

kateve.

Kontrolli i binarëve të dyerve.

Kontrolli i pragjeve të dyerve dhe pastrimi i tyre.

Kontrolli i dyerve për lëvizje të lirë.

Kontrolli i funksionimit të pajisjes së zhblokimit në rastet e evakuimit emergjent.

➤ **Dyert e kabinës:**

Kontrolli hapjes dhe mbylljes së derës. Kontrolli i mbylljes së kontaktit dhe i kyçjes.

Kontrolli i kyçjes së mundshme.

Kontrolli i derës për lëvizje të lirë. Kontrolli i binarëve të derës.

Kontrolli i hapësirës së derës. Kontrolli i lubrifikimit.

Kontrolli i kavos (litarit të çeliktë), zinxhirit apo rripit.

Kontrolli i kompaktësisë së operatorit (mekanizmit) të derës së kabinës.

Kontrolli i funksionimit të sensorëve.

Kontrolli i pragut dhe pastrimi i tij. Kontrolli i forcës mbyllëse të derës.

➤ **Zona fundore e pusit (pit depth):**

Kontrolli i të gjitha komponentëve që të jenë të pastër, të jenë liruar nga pluhuri dhe ndryshku.

Kontrolli i ndriçimit të zonës fundore të pusit.

Kontrolli i nivelit të vajit në mbledhëse të vajit nga binarët.

➤ **Buferët:**

Kontrolli i vendosje së ndërprerësit. Kontrolli i fiksimit (kapjes) së buferëve.

➤ **Rregullatori i shpejtësisë:**

Kontrolli i gjendjes së rregullatorit të shpejtësisë.

Kontrolli i pozitës dhe i fiksimit në binarë/bazament,

Kontrolli i kontaktit elektrik te rregullatorit në qarkun sigures.

Kontrolli i pajisjes me pesha për kavon rregullatorin e shpejtësisë.

Kontrolli i kavos dhe fiksimi i saj për frena të kabinës.

➤ **Frenat e kabinës ose nofullat (Safety gear / Pawl/ Clamping Devices):**

Kontrolli i ndërprerësit elektrik.

Kontrolli i funksionimit dhe distancës nga binari.

Kontrolli i lidhëseve dhe shtrëngimi.

Kontrolli i pjesëve lëvizëse për lëvizje të lirë.

➤ **Pajisja për detektim të lirimit të kavove (Slack rope device):**

Kontrolli i distancës nga kavot deri te pajisja.

Kontrolli i kontaktit elektrik të pajisjes.

Testimi i funksionimit të pajisjes.

➤ **Pjesët rrëshqitëse të kabinës, makarasë:**

Kontrolli i lubrifikimit (lyerjes me vaj ose me mast).

Kontrolli i kapëseve dhe shtrëngimi.

Kontrolli i harxhimit të pjesëve rrëshqitëse dhe nevoja për ndërrim (veshje).

Kontrolli i gjendjes së makarave dhe vajosja e tyre.

➤ **Kavot (litarët metalik):**

Kontrolli i elasticitetit dhe tensionit. Kontrolli i lidhjeve korrekte.

Kontrolli shtrëngimit të njëjtë të gjithë litarëve.

➤ **Binarët (Guide rails):**

Kontrolli i lubrifikimit (vajosjes) në pjesën aktive të binarëve.

Kontrolli i lidhjes në mbështetëse (consoles).

➤ **Ndërprerësit kufitarë:**

Kontrolli i pozitës, shtrëngimit për mbajtësin dhe testimi i funksionimit.

➤ **Lidhjet elektrike:**

Kontrolli përmes vrojtimit i izolimeve dhe gjendjet e lidhjeve.

➤ **Bordi elektronik (Controller):**

Kontrolli i kabinetit që të jetë i pastër, i tharë dhe pa pluhur. Matja e rezistorëve, diodave, optocoupler-ëve për vlerat nominale.

➤ **Invertori (vuvf drive):**

Kontrolli i gjendjes së inverterit dhe fiksimi në mur.

Gjendja e lidhjeve me motor dhe me bordin elektronik.

Ekрани dhe indikatorë të tjerë për funksione të caktuara.

➤ **Motori:**

Kontrolli i kabllor për furnizim elektrik të motorit.

Kontrolli i frenave të motorit dhe aktivizimi/çaktivizimi i tyre në kohë.

➤ **Pajisjet elektrike të sigurisë:**

Kontrolli i funksionimit.

Kontrolli i qarkut elektrik të sigurisë.

Kontrolli i siguresave adekuate nëse janë të vendosura përshtatshëm.

**Ekipi i mirëmbajtjes dhe servisit sigurohet që ashensorët të jenë në gjendje të rregullt.**

Modelet e ashensorëve që Tirana Parking disponon në sheshparkimet e saj paraqitet si më poshtë:

Nr.	Sheshparkimi	Brandi i ashensorit
1	7 Xhuxhat	Ashensor - 3 kate
2	Sheshi Skënderbej	Daka - 2 kate
3	Sheshi Italia	Kleo Ashensor - 3 kate
4	Bulevardi i Ri	Otis - 3 kate
5	Kopshti Zoologjik	Doppler - 2 kate

Konkretisht në mënyrë që të realizohet me sukses mirëmbajtja e ashensorëve nevojiten të kryhen punimet, instalimet, konfigurimet, riparimet etj., si më poshtë:

G1	Ashensorët (SHESHI ITALIA)	Njësia	Sasia
1	Riparim Paketë kontrolli	copë	1
2	Rrip transmisioni	copë	1

3	Riparim Kartë inverteri	copë	1
4	Instalime / Programime	set	1
5	Mirëmbajtje preventivuese	herë	3
<b>G2</b>	<b>Ashensorët (SHESHI SKENDERBEJ)</b>		
1	Riparim Sistem frenimi	copë	1
2	Riparim Motor hidraulik	copë	1
3	Zëvendësim Gomina të ndryshme	copë	1
4	Mirëmbajtje preventivuese	copë	3
5	Instalime / Programime	herë	1
<b>G3</b>	<b>Ashensorët (BULEVARDI I RI)</b>		
1	Riparim Transformator prim/sec 230/18	copë	1
2	Panel komandimi në kabinë	copë	2
3	Riparim Kartë paneli DFC	copë	2
4	Stop emergjence	copë	2

5	Riparim Paketa kontrolli	copë	1
6	Instalime/Programime	set	2
7	Mirëmbajtje preventivuese	herë	3
<b>G4</b>	<b>Ashensorët (7XHUXHAT)</b>		
1	Riparim Sistem frenimi	copë	1
2	Gomina për shasi	copë	4
3	Riparim Mekanizëm për hapje dere	copë	2
4	Riparim Panel butona	copë	2
5	Instalime / Programime	copë	1
6	Mirëmbajtje preventivuese	herë	3
<b>G5</b>	<b>ASHENSORET (PARKU ZOLOGJIK)</b>		
1	Stop emergjence	copë	1
2	Riparim Panel komandues	copë	2
3	Riparim Stop fundor	copë	2

4	Riparim Paketa kontrolli		1
5	Instalime / Programime	copë	1
